

SFIDAT DHE REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIMIN E SHËRBIMIT PËR MBROJTJEN E FËMIJËS NË NIVEL VENDOR

KONTEKSTI

Aktualisht Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë disa reforma të mëdha dhe të rëndësishme. Reforma territoriale ka përcaktuar ndarjen dhe strukturën e re administrative në vend, të miratuar tashmë nga parlamenti.

Përbërja dhe madhësia e njësive vendore ka ndryshuar, me qëllim krijimin e njësive vendore funksionale dhe eficiente në ofrimin e shërbimeve ndaj komuniteteve të tyre.

Ndërkohe që konfigurimi territorial është përcaktuar, Qeveria e Shqipërisë po ndërmerr edhe disa reforma të tjera në fushën e mbrojtjes sociale si:

- "Reforma e Shërbimeve Sociale në Shqipëri", e cila synon decentralizimin e shërbimeve shoqërore, deinstitutionalizimin e shërbimeve të ofruara në qendrat e kujdesit rezidencial dhe të shërbimeve të integruara të kujdesit shoqëror.
- Modernizimi i skemës së ndihmës ekonomike në Shqipëri.

Reforma në sistemin e shërbimeve sociale, synon forcimin dhe fuqizimin e të gjitha niveleve të qeverisjes për të planifikuar, buxhetuar dhe monitoruar shërbime shoqërore të integruara që i përgjigjen nevojave reale të fëmijëve.

Përpjekjet e këtyre dy reformave për të përcaktuar qartësisht përgjegjësitë e njësive vendore, duhet të koordinohen dhe bashkërendohen, njësitë e reja duhet të jenë në gjendje të planifikojnë dhe buxhetojnë ashtu siç duhet shërbimet sociale.

Në këtë këndvështrim ngritja dhe funksionimi i strukturave dhe shërbimeve vendore efikase për mbrojtjen e fëmijëve, është një nga pikat e rëndësishme që duhet të marrim në shqyrtim të përbashkët të dy këto reforma.

SITUATA E PËRGJITHSHME

Bazuar në ligjin Nr 10347 datë 4.11.2010 “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”, organet e qeverisjes vendore morën masat për ngritjen dhe funksionimin e Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF) dhe Njësive për të Drejtat e Fëmijëve (NJDF). Institucionalizimi i strukturave për fëmijët në nivele të ndryshme të qeverisjes vendore ka qenë një nxitje e rëndësishme në marrjen e përgjegjësive për mbrojtjen e fëmijëve

NJDF-ja është struktura përgjegjëse për monitorimin dhe koordinimin e aktorëve për zbatimin e politikave për të drejtat e fëmijëve në territorin e qarkut, si dhe i raporton Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (ASHMDF) mbi situatën e zbatimit të të drejtave të fëmijëve në qark.

NJDF-ja ka një rol të rëndësishëm për të garantuar dhe koordinuar mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi, në ato raste kur bashkitë/komunat nuk kanë ngritur Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve ose nuk kanë kapacitetet për të menaxhuar situatë të tilla .

Në nenin 38 të ligjit të mësipërm theksohet se *“Njësia e të Drejtave të Fëmijëve funksionon brenda strukturës administrative të këshillit të qarkut, si njësi e posaçme ose si njësi e strukturave të ngarkuara me çështje sociale”*.

Deri tani ishin ngritur dhe funksiononin 12 NJDF në të gjithë qarqet e vendit. Funkzioni i NJDF ushtrohej kryesisht nga punonjës të strukturave të ngarkuara me çështje sociale, të cilët ishin ngarkuar edhe me këtë detyrë.

NJDF ka qenë një nxitje e rëndësishme për strukturat e qeverisjes lokale, në marrjen e përgjegjësive për mbrojtjen e fëmijëve, duke rritur ndjeshëm numrin e NJMF-ve të reja. Njëkohësisht është edhe një bashkëpunëtor i rëndësishëm për ASHMDF lidhur me menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik dhe nxitjen e koordinimin e aktorëve vendorë, në ato njësi vendore ku nuk janë ngritur akoma Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijës.

Aktualisht, në bazë të ligjit Nr 160 datë 27.11.2014 “Për buxhetin e vitit 2015”, duke filluar që nga janari i këtij viti, qarqet janë duke u përballur me shkurtimet në buxhet për personelin administrativ. Si rrjedhojë, këshillat e qarqeve po ristrukturojnë organigramën e tyre dhe në disa raste NJDF-ja nuk është parashikuar në organigramën e re, në kundërshtim me dispozitat e ligjit Nr. 10347, datë 4.11.2010 “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve” si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.


Në datë 27.01.2015 ASHMDF i ka dërguar një shkresë krytarëve të qarqeve dhe prefektëve, me të cilën kërkon përfshirjen e Njesisë së të Drejtave të Fëmijëve brenda strukturave të reja administrative të këshillave të qarqeve.

Aktualisht 5 qarqe e kanë konfirmuar NJDF, qarqet Elbasan, Kukës, Vlorë, Berat, Vlorë. Situata është shqetësuese për qarqet Korçë, Fier, Tiranë dhe pritet të merret konfirmimi për NJDF në qarqet Lezhë, Shkodër, Gjirokastër, Dibër.


Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve funksionojnë brenda strukturës administrative të bashkisë/komunës, si njësi e posaçme ose si njësi e strukturave të ngarkuara me çështje sociale dhe kanë për detyrë të identifikojnë dhe menaxhojnë rastet e fëmijëve në rrezik, që ndodhen brenda zonës ku kjo njësi shtrin juridiksionin e saj. Aktualisht në të gjithë vendin janë ngritur dhe funksionojnë **196 NJMF**.

Aktualisht rreth 51% e njësive vendore, mbulohet me shërbimin e NJMF-ve. Progresi në ngritjen e njësive nuk ka qënë i njëjtë për të gjithë qarqet. Qarqet si Vlorë dhe Durrës kanë mbuluar pothuajse të gjithë territorin e tyre me këtë shërbim, ndërsa Gjirokastra dhe Shkodra kanë mbulim të vogël, respektivisht 3% dhe 15% të territorit. Numrin më të madh të NJMF të ngritura e ka qarku i Elbasanit, me rreth 35 NJMF.

Për periudhën 2013-2014, është e rëndësishme të përmendet ngritja dhe funksionimi i NJMF të reja në bashkinë e Tiranës dhe në qarkun e Korçës. Ndonëse me vonesë, Bashkia e Tiranës mundësoi ngritjen e 10 NJMF të reja në secilën Njësi Bashkiake.



Burimi:
ASHMDF



Burimi: ASHMDF

Mirëfungsioni i sistemit të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve varet veçanërisht nga autoritetet vendore, të cilët duhet të njohin rolin dhe përgjegjësitë e tyre për të siguruar kujdes dhe mbrojtje për fëmijët dhe të koordinojnë veprimet e tyre me aktorët e tjerë vendorë të angazhuar në çështjet e mirëqenies së fëmijëve.


Ndonëse brenda përcaktimeve ligjore, në komuna dhe disa bashki të vogla, roli i NJMF i mbivendoset rolit të administratorit shoqëror. Rrjedhimisht duke iu ngarkuar disa detyra njëherësh ngarkesa e punës është më e madhe dhe koha për t'ju kushtuar rolit si NJMF është më e kufizuar.

Aktualisht janë 32 NJMF që kanë vetëm këtë funksion, ndërsa 164 NJMF janë edhe administratorë shoqërorë.

Ndysimet e shpeshta në stafin e NJMF, që lidhen kryesisht me ndryshimin e drejtuesve të institucioneve vendore, pengojnë krijimin e një modeli të qëndrueshëm për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, si një element i rëndësishëm në zhvillimin e një sistemi kombëtar për mbrojtjen e tyre. Duke vlerësuar rolin dhe përgjegjësinë që kanë këto struktura në punën e drejtpërdrejtë me fëmijët dhe familjet e tyre, kjo problematikë bëhet dhe më e ndjeshme. Shpeshherë mungesa e eksperiencës apo edhe e kualifikimit për punonjësit e rinj reflektohet edhe në produktivitetin e punës së tyre.

Rreth 78% e NJMF janë aktive dhe raportojnë rregullisht pranë ASHMDF. Në përgjithësi raportimet janë nga NJMF-të e bashkive, të cilat kanë më shumë përvojë. Nga raportimet del se 145 NJMF kanë pasur të paktën 1 rast ose asnjë rast për të menaxhuar për periudhën janar – qershor 2014. Është e nevojshme të përmirësohet cilësia e raportimit të rasteve të menaxhuara nga NJMF, megjithatë kjo është një problematikë që do të targetohet gjatë trainimeve për zbatimin e Udhëzimit për procedurat e mbrojtjes së fëmijëve.

Për vitin 2013, NJMF të cilat kanë raportuar pranë ASHMDF-së kanë menaxhuar **1321** raste të fëmijëve në rrezik nga këto 537 ishin raste të reja. Për vitin 2014 NJMF kanë menaxhuar rreth 1407 raste. Nga këto 703 janë raste të reja për vitin 2014.



Burimi :ASHMDF

Agjencia per vitin 2014 ka referuar tek institucionet përgjegjëse dhe ka ndjekur ecurinë e zgjidhjes për 43 raste të fëmijëve. Nga këto 28 raste kanë qënë raste të bëra publike në media, ndërsa pjesa tjetër (15 raste) janë referuar në ASHMDF nga aktorë dhe partnerë të ndryshëm.

Nga 43 rastet e sipërpërmendura, 8 prej tyre janë raste të abuzimit apo tentativës për abuzim seksual, 7 janë raste të abuzimit fizik dhe psikologjik ndërsa pjesa tjetër janë raste në vështirësi ekonomike.

Rastet e menaxhuara janë kryesisht raste të fëmijëve në rrezik apo viktima të dhunës, abuzimit, neglizhencës apo shfrytëzimit. Përgjithësisht fëmijët në rrezik vijnë nga familje të varfëra dhe janë përballur me situata dhune në familje, abuzimi fizik e seksual, shfrytëzim për punë në rrugë, trafikimi si dhe në shumë raste neglizhimi nga prindërit apo përsnat kujdestarë në përmbushjen e nevojave të tyre bazë për mbijetesë.

Qeveria shqiptare ka filluar Reformën Administrativo-Territoriale e cila synon të ulë ndjeshëm numrin e ndarjeve administrative në vend dhe është duke hartuar strategjinë e re të decentralizimit, strategji që do të rishikojë funksionet qeverisëse të niveleve vendore. Në këtë kuadër ASHMDF do të advokojë për forcimin e NJMF, duke rritur burimet dhe kapacitetet njerëzore dhe financiare, për të ofruar shërbime të një cilësie të lartë për fëmijët dhe familjet.

Në shkurt 2015 u miratua Udhëzimi i përbashkët i 4 Ministrave për mbrojtjen e fëmijëve në rrezik, një dokument që përcakton qartë rolet dhe unifikon procedurat për identifikimin, referimin dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, për të gjithë institucionet, organizatat dhe institucionet publike apo private të cilat punojnë me fëmijët dhe kanë përgjegjësi për mbrojtjen e tyre.

MONITORIMI I PUNËS SË NJËSIVE PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE NË TERREN

Bazuar në ligjin Nr 10347 datë 4.11.2010 “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (ASHMDF), ka përgjegjësi të monitorojë dhe të kontrollojë zbatimin e këtij ligji. Më konkretisht, në *VKM Nr 266 datë 12.04.2012 “Për bashkërendimin e veprimtarisë së mekanizmave në nivel qendror dhe vendor për çështjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”*, në nenin 3 theksohet se “ASHMDF bashkëpunon me Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijës (NJMF) në nivel bashkie/komune për të garantuar zbatimin e legjislacionit dhe politikave shtetërore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, nëpërmjet, monitorimit të zbatimit të detyrave të kësaj strukture të përcaktuara në nenin 39 të Ligjit Nr 10347 datë 4.11.2010 “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës”.

Gjatë periudhës tetor – dhjetor 2014, ASHMDF ka realizuar monitorimin e drejtpërdrejtë në terren të Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve, me synim për:

- Të siguroar një pasqyrë e situatës reale të rasteve, problematikave dhe zbatimit të të drejtave të fëmijëve për mbrojtje nga dhuna, abuzimi, shfrytëzimi;
- Të identifikuar çështjet më kritike lidhur me punën dhe shërbimin e ofruar nga NJMF-ja, me qëllim hartimin e rekomandimeve për përmirësimin e politikave për mbrojtjen e fëmijëve në të ardhmen;
- Të hartuar rekomandime për drejtimet, në të cilat nevojitet mbështetje institucionale apo financiare, nga qeveria apo shoqëria civile.

Proçesi i monitorimit u pilotua në 10 NJMF në bashkitë Elbasan, Fier, Pogradec, Kukës, Berat, Durrës, Vlorë, Shkodër, Njësitë Bashiake Nr.5 dhe Nr.9 në Tiranë.

Përzgjedhja e NJMF-ve për monitorim, është bërë duke marrë në konsideratë shtrirjen gjeografike si dhe ndryshimet e mundshme në shpërndarjen e njësive të qeverisjes vendore, që do të ndodhin në kuadër të reformës së re territoriale.

Monitorimi i punës së NJMF u realizua sipas një metodologjie të përcaktuar. Grupi i monitorimit mblodhi informacion statistikor në lidhje me rastet e ndjekura nga NJMF si dhe nëpërmjet një interviste të gjysëm-strukturuar u mblodh informacion cilësor në lidhje me zbatimin e përgjegjësive, mënyrën e punës së NJMF-ve për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik dhe ndjekjen e procedurave ligjore, për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi.

Funksionimi

Sipas dispozitave të miratuara me Ligjin 10347, Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës funksionon brenda strukturës administrative të bashkisë/komunës, si njësi e posaçme ose si njësi e strukturave të ngarkuara me çështjet sociale.

Në të gjitha Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijës aktualisht ka vetëm 1 person të punësuar për këtë detyrë. Nga 10 NJMF të monitoruara vetëm 2 prej tyre, NJMF e bashkive Berat dhe Shkodër, kishin edhe funksionin e administratorit social, ndërsa NJMF e tjera ishin të ngarkuara vetëm me këtë funksion. NJMF e Elbasanit është njëkohësisht edhe shefe e sektorit në Drejtorinë së Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale. Ngritja në detyrë, ndonëse ka rritur profilin e NJMF-së së Elbasanit, ka rritur gjithashtu edhe ngarkesën e punës, kryesisht punë administrative, duke ndikuar në rrjedhën e punës me fëmijët në rrezik.

Të gjitha NJMF ishin pjesë e organigramës së Drejtorive të Shërbimeve Sociale në bashki. Kishin mbështetje dhe marrëdhënie të mira me eprorët e tyre. Puna e NJMF njihet edhe nga strukturat politikëbërëse të bashkive dhe vlerësohet si e rëndësishme për trajtimin e fëmijëve në rrezik.

NJMF kanë mbështetje të gjërë institucionale brenda bashkive respektive, por nuk kanë asnjë mbështetje financiare nga buxheti vendor për trajtimin e rasteve të fëmijëve në rrezik. Në shumë vende prioritetet e qeverisjes vendore janë të drejtuara drejt iniciativave nëpërmjet të cilave përfitojnë të gjithë anëtarët e komunitetit, si rrugë e infrastrukturë, dhe jo në mbrojtjen e shtresave të rrezikuara. Mungesa e buxhetit për të menaxhuar rastet e fëmijëve, aktualisht mbetet sfida më e madhe për punën dhe funksionimin e NJMF.

Sipas detyrave të përcaktuara në legjislacion, NJMF duhet ta shtrijnë shërbimin e tyre duke filluar që nga shërbimet sensibilizuese e parandaluese e deri tek menaxhimin i rasteve në rrezik. Kjo është një gamë shumë e gjërë detyrash duke marrë parasysh kufizimet që ka në nivel vendor lidhur me buxhetet dhe shërbimet,.

NJMF në bashkëpunim me aktorë të tjerë vendorë, kryesisht shkollat, organizojnë mesatarisht 3-4 aktivitete sensibilizuese në vit. Pjesa tjetër e ndërhyrjeve lidhet me menaxhimin e rasteve të identifikuar. Ngarkesa e punës së NJMF ndryshon në bashki të ndryshme të vendit. Në bashkitë e mëdha ku popullsia shkon rreth 80 000 – 100 000 banorë (kryesisht bashkitë Elbasan, Fier, Vlorë, Shkodër), për periudhën në monitorim, NJMF kanë menaxhuar rreth 70 – 100 raste secila, një ngarkesë shumë e madhe pune duke marrë parasysh mungesat në buxhet dhe në mjetet e logjistikës.

Monitorimi në vazhdimësi i rasteve, nëpërmjet vizitave në familje, është një hap i domosdoshëm për të siguruar se fëmijët dhe/ose familja po marrin shërbimin e duhur. Të gjitha NJMF janë shprehur se e kanë të vështirë të ndjekin rastet dhe të kryejnë vizita në familje, kur nuk kanë asnjë mjet transporti në dispozicion. Në të shumtën e rasteve NJMF janë përpjekur për të bashkëpunuar me OJF-të dhe institucione të tjera, si p.sh policia, për të ndarë transportin, por kjo nuk është gjithmonë e mundur. Ngritja e strukturave vendore më të mëdha si rrjedhojë e reformës territoriale do ta vështirësojë edhe më shumë këtë aspekt të punës së NJMF-ve.

Dy NJMF raportuan se për arsye të mungesës së logjistikës dhe mjeteve të transportit e kanë kaluar procesin e identifikimit dhe monitorimit tek partnerët e tjerë. Roli i tyre është kufizuar

vetëm në koordinimin, referimin dhe ndjekjen e rasteve emergjente. Kjo praktikë pune nuk është në përputhje me legjislacionin. NJMF duhet të ushtrojë të gjitha funksionet e saj, duke përfshirë këtu të gjitha aspektet e punës në terren dhe punës me familjen.

Për arsye të etikës, por edhe të sigurisë fizike të NJMF, vizitat në familje realizohen kryesisht bashkë me administratorin shoqëror apo policinë, të cilët i vijnë në ndihmë NJMF edhe në rastet kur familjet nuk janë bashkëpunuese.

Për procesin e mbylljes së rastit, kur rasti nuk konsiderohet në rrezik, shumica e NJMF shprehen se e marrin këtë vendim në konsultim me eprorin e tyre dhe aktorët të tjerë që e njohin rastin. Megjithatë duket se në përgjithësi aktorët vendorë dhe drejtuesit e NJMF mbështesin punën e NJMF dhe ndjekin propozimet e saj për mbylljen e rasteve.

Mbështetja, këshillimi i NJMF nga persona të kualifikuar, veçanërisht për menaxhimin e rasteve të vështira, ishte një kërkesë dhe domosdoshmëri për shumicën e NJMF. Drejtuesit e tyre janë bashkëpunues dhe ndihmojnë NJMF edhe gjatë procesit të menaxhimit të rasteve. Megjithatë monitorimi dhe mbikqyerja e punës për menaxhimin e rastit nga drejtues teknikë e të kualifikuar mbetet problem për të gjitha NJMF.

Grupet multidisiplinare dhe bashkëpunimi ndërinstytucional

Ligji 10347 date 4.11.2010 “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij janë shumë të qarta në lidhje me rolet dhe përgjegjësitë e aktorëve vendorë për mbrojtjen e fëmijëve. NJMF u shprehën se pas miratimit të ligjit, bashkëpunimi me partnerët është më i qartë dhe kjo u ka dhënë “pushtet” më të madh për të thirrur takime multidisiplinare dhe për të vendosur mbi përgjegjësitë dhe detyrat që duhet të plotësohen nga aktorët vendorë për menaxhimin e rasteve.

NJMF-të u shprehën se bashkëpunimi me institucionet në nivel vendor për menaxhimin e rasteve është rritur. Shpesh herë ky bashkëpunim për menaxhimin e rasteve është i lidhur me personalitetin e personave të përfshirë, p.sh NJMF e Vlorës punon ngushtë me drejtorët e shkollave dhe psikologët, por ka shumë pak mbështetje nga Drejtoria Arsimore Rajonale.

Në përgjithësi policia dhe shkollat janë institucionet vendorë me të cilët bashkëpunojnë më shpesh NJMF.

Në disa raste fokusi i ngjashëm i punës së NJMF-ve dhe Shërbimit Social Rajonal ka sjellë vështirësi në bashkëpunimin ndërmjet tyre, kryesisht për fushën e veprimit të secilit institucion dhe mënyrën e menaxhimit të rasteve të fëmijëve në rrezik. Kjo tregon për nevojën e përcaktimit të roleve të qarta që rregullojnë bashkëpunimin mes këtyre strukturave.

Grupet teknike multidisiplinare (GTM) mblidhen për menaxhimin e rasteve në rrezik të mesëm dhe të lartë. Rastet në rrezik të ulët menaxhohen nga NJMF. Për rastet më pak të komplikuar dhe me rrezik më të ulët organizohen takime individuale me aktorët e nevojshëm për zgjidhjen e

rastit. Kjo është një qasje pragmatike, që shumë nga NJMF kanë përdorur për të menaxhuar volumin e rasteve, por sidomos për menaxhimin e tyre, duke pasur parasysh mungesën e llojshmërisë së shërbimeve për fëmijë në nivel vendor.

Mbledhja e GTM zakonisht është e rregullt për takimin e parë, kur NJMF paraqet rastet e reja të fëmijëve në rrezik. Takimet për rivlerësimin e rastit janë shumë të rralla ose pothuajse nuk ndodhin. NJMF kontakton individualisht çdo anëtar të grupit teknik multidisiplinar, lidhur me ecurinë e rastit. Institucionet vendore jo gjithmonë dërgojnë të njëjtët persona në takimet e GTM, apo personat e duhur që e njohin rastin. Ky funksion nuk i është “veshur” asnjë punonjësi në institucionet vendore. Ata marrin pjesë në mbledhje bazuar në urdhërin e drejtuesit të institucionit, të dhënë rast pas rasti dhe shpesh e shikojnë si “punë shtesë”.

Ndryshe nga të gjitha NJMF e bashkive të tjera në vend, në bashkinë Elbasan mbledhja e aktorëve të GTM, marrja e përgjegjësive nga ana e tyre dhe përmbushja e këtyre përgjegjësive, nuk paraqet problem për NJMF. Një nga arsyt kryesore të suksesit të NJMF është krijimi i një mjedisi bashkëpunues me aktorë të ndryshëm (institucione dhe OJF) të mbrojtjes së fëmijëve. Aktorët vendorë që janë pjesë e GTM mblidhen rregullisht jo vetëm për të diskutuar mbi rastet, por edhe për të bashkërenduar punën me njëri-tjetrin, për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta apo shmangjen e mbivendosjes së shërbimeve të njëjta për fëmijët dhe familjet në nevojë, p.sh çdo fillim të vitit shkollor të gjithë aktorët vendorë mblidhen dhe bëjnë një analizë të situatës lidhur me nevojat e fëmijëve, kryesisht të fëmijëve rom, për fillimin e vitit shkollor si dhe situatën e braktisjes shkollore brenda territorit të bashkisë.

Bashkëpunimi me Njësinë e të Drejtave të Fëmijëve (NJDF) është i mirë dhe ndodh zakonisht kur ky bashkëpunim kërkohet nga NJDF. Përvec shkëmbimit të informacionit periodik, të dyja strukturat bashkëpunojnë edhe për menaxhimin e rasteve në komuna apo bashki të qarkut që nuk e kanë ngritur akoma NJMF.

Bashkëpunimi me ASHMDF vlerësohet pozitivisht, veçanërisht procesi i monitorimit shihet si i nevojshëm. Megjithatë NJMF theksojnë se ASHMDF duhet të dalë më në pah si një institucion që:

- Mbron, promovon dhe lobon në nivel qendror dhe në nivel vendor për rolin dhe punën e NJMF
- Ndihmon financiarisht apo lobon me bashkinë apo MMSR për caktimin e një fondi të vecantë për NJMF, për trajtimin dhe mbështetjen e rasteve emergjente
- Ofron mbështetje teknike të specializuara, për raste të vështira
- Luan një rol koordinues ndërmjet të gjitha NJMF, jo vetëm për shkëmbimin e eksperiencave, por edhe për bashkërendimin e punës ndërmjet NJMF lidhur me rastet e fëmijëve në rrezik që janë vazhdimisht në lëvizje në territorin e vendit.

Dosjet, mbajtja e të dhënave

Cilësia dhe mënyra e mbajtjes së të dhënave varion nga njëra NJMF tek tjetra. Vetëm tek dy NJMF, në bashkinë e Vlorës dhe bashkinë e Beratit, u gjetën të gjitha dosjet e fëmijëve në hardcopy, në përputhje me numrin e rasteve në menaxhim të raportuara nga vetë NJMF.

Të dhënat për fëmijët mbahen në mënyra të ndryshme p.sh dokumentat e fëmijëve bashkë me ndonjë raport vlerësimi mbahen në dosje, informacioni për vizitat në familje mbahet në bllok shënimesh apo file të përgjithshëm ku shënohen vizitat në familje. Disa nga NJMF kanë përdorur një database të veçantë, për dokumentimin e rasteve më të hershme se 2014.

Legjislacioni në këtë drejtim thekson se *“NJMF duhet të ruajnë të dhëna për çdo fëmijë në mënyrë hardcopy dhe elektronike”* dhe nuk ka përcaktuar formatin sipas të cilit duhet të mblidhen dhe ruhen këto të dhëna. Kjo është edhe një nga arsyet e shumëllojshmërisë së ruajtjes së të dhënave nga NJMF.

Sidomos për vitin 2014, NJMF i kanë ruajtur të dhënat në file ëord apo excel. Kjo praktikë ka shërbyer më tepër për regjistrimin e emrave dhe numrit të fëmijëve në ndjekje, për efekt të raportimit në ASHMDF apo pranë strukturave të bashkisë, sesa për dokumentimin e hapave për menaxhimin e rasteve.

Gjatë monitorimit NJMF –të vunë në dukje rëndësinë e përcaktimit në legjislacion të formateve të unifikuar për mbajtjen e të dhënave për fëmijët. Ky problem do të marrë zgjidhje me miratimin e Udhëzimit për Mbrojtjen e Fëmijëve, ku përcaktohen në mënyrë të detajuar mënyra e plotësimit të dosjes së fëmijës.

Mbajtja e të dhënave të detajuara të punës me rastet është e rëndësishme, pasi përbën një mjet për monitorimin e cilësisë së shërbimeve dhe të punës së NJMF. Gjithashtu nënkupton edhe mundësinë që puna e kryer aktualisht nga NJMF, të mund të vazhdohet edhe në të ardhmen nga persona të tjerë.

Aksesueshmëria

Aksesueshmëria e zyrës së NJMF është problem për shumicën e bashkive. Disa NJMF kanë zyrat e tyre, por shumica e NJMF janë vendosur në zyra me persona të tjerë dhe kanë pak ose aspak hapësirë për ruajtjen e të dhënave apo kryerjen e intervistave dhe takimeve me familjet e fëmijët. Përveç kësaj, shumë nga zyrat janë të vendosura në katet e sipërme të ndërtesave, prandaj dhe aksesueshmëria nga njerëzit me fëmijë të vegjël ose me aftësi të kufizuara fizike është e vështirë. Nuk ka një numër telefoni për NJMF që të njihet nga publiku.

Aftesitë profesionale

Në pikën 3, neni 39 i Ligjit 10347 *“Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”* theksohet se *“Në Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijës në bashki/komunë të ketë të paktën një punonjës me formim në*

fushën sociale”. Gama e aftësive dhe kualifikimeve për NJMF ndryshon në të gjithë vendin, por NJMF që u morën në monitorim kishin formim në shkenca shoqërore dhe ishin në këtë pozicion pune që kur bashkia respektive kishte marrë vendimin për hapjen e Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijës. Eksperienca e tyre në punë ndryshon shumë.

NJMF e Fierit, Elbasanit dhe Pogradecit janë punonjëset më me shumë eksperiencë, rreth 7-8 vjet, NJMF e Vlorës, Durrësit, Njesisë bashkiake Nr 9, Shkodrës rreth 5-6 vjet eksperiencë, NJMF e Beratit dhe Kukësit rreth 2 vjet eksperiencë, ndërsa NJMF e ngritur në Njesisë Bashkiake Nr. 5 në Tiranë ka rreth 7 muaj eksperiencë në këtë pozicion.

Eksperienca e gjatë në punë dhe trainimet, kanë ndikuar në rritjen e njohurive dhe aftësive profesionale të NJMF. Disa nga NJMF që kishin marrë pjesë në kursin 1 vjeçar për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve në Fakultetin e Tiranës, u shprehën se kishte qënë një eksperiencë e mirë dhe që i kishte rritur profesionalisht. Megjithatë eksperienca dhe trainimet nuk janë elementët e vetëm që tregojnë për cilësinë e shërbimit të NJMF.

Monitorimi nga supervisorët apo drejtorët e tyre është i domosdoshëm për të siguruar që NJMF ofrojnë shërbimin sipas kërkesave të legjislacionit.

Të dhëna mbi rastet e fëmijëve në rrezik

Për periudhën janar – dhjetor 2014, NJMF që u monitoruan kishin menaxhuar **546** raste të fëmijëve në rrezik. Nga keto **219** raste ishin të reja dhe **25** raste ishin në rrezik të menjëhershëm. Gjatë 2014, NJMF në monitorim kanë realizuar rreth **614** vizita në familje për vlerësimin dhe ndjekjen e rasteve. Pas vlerësimeve të rasteve të identifikuar rezultoi se **95** raste janë referuar tek institucione të tjera dhe nuk ka qënë më e nevojshme ndjekja nga NJMF. Për 2014 NJMF- të kanë vlerësuar mbylljen e **140** rasteve.

Sipas NJMF, në familjet e varfëra dhe në familjet me probleme social – ekonomike, janë hasur më shpesh rastet e dhunës në familje dhe neglizhimit të fëmijës. Pas këtyre rasteve, fëmijët në situatë rruge dhe braktisja shkollore janë problematikat që trajtojnë më shpesh NJMF.

Numri më i madh i rasteve është identifikuar nga NJMF dhe prindërit, megjithatë edhe administratorët socialë, OJF, policia dhe institucionet arsimore duket se kanë pasur një rol të rëndësishëm.

Neglizhimi i prindërve/kujdestarëve ndaj përmbushjes së nevojave themelore të fëmijëve është lloji më i përhapur i abuzimit. Rreth 54% e rasteve ku është evidentuar abuzim ndaj fëmijëve, kanë qënë raste të lidhura me neglizhimin dhe mospërmbushjen e detyrimeve prindërore ndaj fëmijëve. Rastet e neglizhimit janë identifikuar më tepër në bashkitë Fier, Pogradec, Elbasan, Berat dhe Shkodër

Rastet e më të shumta të abuzimeve fizike janë trajtuar në bashkitë Elbasan dhe Fier (kjo është e kuptueshme se janë bashkitë më numrin më të madh të rasteve). Rastet e abuzimit psikologjik, kryesisht janë raste kur fëmijët kanë qënë të pranishëm kur ushtrohej dhunë ndaj personave të tjerë dhe janë identifikuar më tepër në bashkitë Pogradec, Fier, Kukës, Elbasan.

Nga të dhënat vihet re se disa NJMF të tjera, përveç NJMF të Tiranës, kanë identifikuar problemin dhe kanë nisur punën me fëmijët në situatë rruge. Kjo lehtëson edhe përhapjen e nismës për mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge dhe familjeve të tyre, edhe në njësi të tjera vendore.

Numri i rasteve të fëmijëve në ndjekje sipas problematikave

- Dhunë në familje **119**
- Dhunë në institucion **1**
- Varfëria **234**
- Mosregjistrimi **24**
- Braktisja shkollore **41**
- Situatë rruge **40**
- Puna e fëmijëve **33**
- Te mitur te pashoqëruar
(të kthyer nga jashtë) **6**
- Te tjera **48**

Numri i rasteve të fëmijëve në ndjekje sipas llojit të dhunës/abuzimit

- Abuzim fizik **70**
- Abuzim seksual **2**
- Abuzim psikologjik **74**
- Neglizhim **169**

Numri i rasteve të fëmijëve në ndjekje sipas faktorëve të vulnerabilitetit

- Fëmijë me aftësi të kufizuar **28**
- Femije ne konflikt me ligjin **3**
- Pa kujdes prinderor **46**
- Fëmijë nga familje me probleme
social – ekonomike **384**
- Tjetër **57**

REKOMANDIME

- Ngritja e Njësive të Mbrojtjes së Fëmijëve në të gjitha bashkitë e Shqipërisë, duhet të jetë një detyrim ligjor për njësitë e reja administrative që do të formohen si rezultat i reformës territoriale. Bashkitë e reja duhet të ruajnë kapitalin njerëzor të krijuar gjatë viteve të fundit dhe fuqizojnë NJMF me më shumë se 1 staf.

- Bashkitë duhet gjithashtu të sigurojnë burimeve të nevojshme financiare, lidhur me shërbimin për rastet emergjente që menaxhon NJMF si dhe mjete logjistike që mundësojnë vizitat në familje të NJMF.
- Duhet të ngrihen lloje të reja shërbimesh: shërbime të specializuara për mbrojtjen e fëmijëve në raste specifike siç mund të jenë forma shumë të rënda të abuzimit apo ri-integrimi i fëmijëve në konflikt me ligjin; si dhe shërbime apo programe për rritjen e kapaciteteve prindërore të prindërve, apo fuqizimin e familjeve. Shërbimet e specializuara duhet të përfshijnë shërbimet për mbrojtjen apo trajtimin e rasteve të dhunës apo abuzimeve seksuale ndaj fëmijëve, duke përfshirë trajnimin e specializuar të profesionistëve, garantimin e mbrojtjes efikase të fëmijëve dhe shmangjen e riviktimizimit.
- Udhëzimi i përbashkët i 4 ministrave mbi Proçedurat për Mbrojtjen e Fëmijës duhet të njihet dhe zbatohet nga strukturat në nivel vendor. Institucionet vendore duhet të përcaktojnë personat përgjegjës për çështjet e fëmijëve, të cilët duhet të marrin pjesë rregullisht në takimet e grupeve teknike multidisiplinare.
- Të dhënat për fëmijët, lidhur me mënyrën e menaxhimit të rasteve, duhet të dokumentohen dhe të ruhen sipas kërkesave të Udhëzimit. Është i nevojshëm dixhitalizimi i të dhënave të NJMF si dhe vendosja e një sistemi online të monitorimit të të dhënave për të gjitha NJMF.
- Duhet hartuar standarte për monitorimin e punës për mbrojtjen e fëmijëve. Inspektimi dhe monitorimi i cilësisë së shërbimit/punës së NJMF është një kërkesë urgjente.
- Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës duhet të kenë mundësi të zhvillojnë kapacitetet e tyre profesionale sidomos për punën në terren. Ata duhet të kenë mundësinë për të diskutuar rastet dhe eksploruar strategji të reja ndërhyrjeje me dikë që ka aftësitë dhe njohuritë e nevojshme. Duhet të shikohen mundësitë apo mënyrat e bashkëpunimit që NJMF me përvojë të mbështesin NJMF e reja.
- Duhet të forcohet roli koordinues dhe monitorues i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, e cila duhet të ketë kapacitete të mjaftueshme njerëzore, teknike dhe financiare për të koordinuar në mënyrë efektive veprimet/ndërhyrjet për të drejtat e fëmijëve në nivel kombëtar dhe vendor.

Të dhënat statistikore të punës së NJMF për periudhën janar – dhjetor 2014¹

NJMF	1. Numri i fëmijëve që janë menaxhuar brenda këtij viti sipas:										2. Numri i rasteve të reja për këtë vit sipas:									
	Total	Gjinsë		Grupmoshës			Etnisë				Total	Gjinsë		Grupmoshës			Etnisë			
		Femra	Meshkuj	0-6	7-14	15-18	Romë	Egjiptjane	P.M (shqiptare)	Të tjera		Femra	Meshkuj	0-6	7-14	15-18	Romë	Egjiptjane	P.M (shqiptar)	Të tjera
Durres	25	13	12	6	18	1	6	3	16	0	13	7	6	3	9	1	3	1	9	0
Shkoder	61	26	35	9	25	27	0	10	51	0	38	18	20	6	18	14	0	8	30	0
Njesia 5	31	15	16	15	15	1	18	0	13	0	29	3	26	15	13	1	16	0	13	0
Kukes	28	16	12								21	12	9	5	12	3				
Vlore	125	63	62	17	63	45	16	45	61	3	10	6	4	1	6	3	4	4	2	0
Berat	34	15	19	12	19	3	4	20	10	0	29	12	17	12	16	1	4	20	5	0
Elbasan	73	34	39	36	31	6	21	33	19	0	36	19	17	10	22	4	9	15	12	0
Fier	115	78	37	68	39	8	0	0	115	0	18	9	9	7	9	2	0	0	18	0
Pogradec	54	36	18	6	44	4	24	19	11	0	25	15	10	2	19	4	11	8	6	0
Total	546	296	250								219	101	118	61	124	29				

NJMF	3. Numri i rasteve të fëmijëve të identifikuar/referuar nga:											4. Numri i fëmijëve në rrezik të menjëhë	5. Numri i vizitave në terren me qëllim:		
	NJMF	Policia	OJF	Prindi	Fëmija	Institucion arsimore	Institucion shëndetësor	Administratori i NE	Media	Të tjere	Identifikimin		Vlerësimin e rasteve	Ndjekjen e ecurise	
Durres	0	2	2	6	0	4	0	0	8	3	9	0	9	0	
Shkoder	10	2	14	30	1	2	1	0	1	0	1	10	25	32	
Njesia 5	19	0	0	8	0	1	0	0	0	2	2			50 (total)	
Kukes	10	18	0	0	0	0	0	0	0	0	0			30 (total)	
Vlore	31	2	23	17	0	1	0	35	1	15	1	0	10	125	
Berat	11	0	10	4	0	4	0	0	0	0	4	10	38	10	
Elbasan	25	0	2	0	0	0	0	3	2	2	8	0	32	108	
Fier	27	20	5	10	13	25	0	12	3	0	0			115 (total)	
Pogradec	14	4	2	6	0	8	6	12	2	0	0	20	42	68	
Total	147	48	58	75	14	45	1	62	17	22	25				

¹ Të dhënat për NJësinë Bashkiake Nr. 9 nuk janë përfshirë

NJMF	6. Numri i rasteve të fëmijëve në ndjekje sipas problematikave:										7. Numri i rasteve të fëmijëve në ndjekje sipas llojit të dhunës/abuzimit			
	Dhunë në familje	Dhunë në institucione (specifiko)	Varfëria	Mosregjistrimi	Braktisja shkollore	Trafikimi	Situatë rruge	Puna e fëmijëve	Te mitur te pashoqëruar (të kthyer nga jashtë)	Te tjera	Abuzim fizik	Abuzim seksual	Abuzim psikologjik	Neglizhim
Durres	4	0	7	0	2	0	3	0	0	9	4	0	0	3
Shkoder	14	1	34	3	3	0	4	2	0	0	2	0	2	10
Njesia 5	0	0	23	3	1	0	4	0	0	0	0	0	0	5
Kukes	16	0	12	0	0	0	0	0	0	0	0	0	15	0
Vlore	0	0	73	1	16	0	4	0	0	31	0	0	3	0
Berat	4	0	17	5	4	0	3	0	0	1	7	0	3	19
Elbasan	13	0	19	6	7		10	7	6	5	19	2	12	40
Fier	60	0	35	0	0	0	0	20	0	0	30	0	15	70
Pogradec	8	0	14	6	8	0	12	4	0	2	8	0	24	22
Total	119	1	234	24	41		40	33	6	48	70	2	74	169

NJMF	8. Numri i rasteve të fëmijëve në ndjekje sipas faktorëve të vulnerabilitetit					9. Numri i rasteve të identifikuara që nuk janë ndjekur nga NJMF, por janë referuar te institucione të tjera	10. Numri i rasteve të mbyllura
	Fëmijë me aftësi të kufizuar	Fëmijë në konflikt me ligjin	Pa kujdes prinderor	Fëmijë nga familje me probleme social – ekonomike	Tjetër		
Durres	2	0	3	7	13	3	20
Shkoder	3	1	10	47	0	20	16
Njesia 5	0	0	0	31	0	10	1
Kukes	0	0	12	16	0	0	12
Vlore	16	2	2	73	32	16	27
Berat	1	0	4	29	0	0	3
Elbasan	0	0	9	36	0	14	14
Fier	2	0	0	113	0	11	13
Pogradec	4	0	6	32	12	7	34
Total	28	3	46	384	57	95	140